

PROGRAMET E REFORMAVE EKONOMIKE BALLKANI PERËNDIMOR DHE TURQIA

Që nga viti 2015, të gjitha vendet kandidate të BE-së dhe kandidatet potenciale përgatisin Programe të Reformave Ekonomike (ERP). Programet i përgatisin vendet e zgjerimit për pjesëmarrjen e tyre të ardhshme në procedurat e koordinimit të politikave ekonomike të BE-së. Ato gjithashtu luajnë një rol kyç për përmirësimin e planifikimit të politikave ekonomike dhe drejtimin e reformave për të mbështetur stabilitetin makroekonomik, për të nxitur konkurrencën dhe për të përmirësuar kushtet për zhvillimin gjithëpërfshirës dhe krijimin e vendeve të punës. Programet janë një element kyç i qasjes “në fillim parimet” në strategjinë e zgjerimit të BE-së.



Fusha të gjera reformash



Mjedisi i biznesit



Reforma e energjisë dhe tregut të transportit



Fusha kërkimore, zhvillimi dhe inovacioni dhe ekonomia digjitale



Tregtia



Arsimi dhe aftësitë



Punësimi dhe tregu i punës



Mbrojtja sociale dhe përfshirja



SFIDAT KYÇE TË IDENTIFIKUARA

- Nevoja të mëtejshme për të forcuar **FINANCAT PUBLIKE** dhe për të reduktuar **MOSBALANCIMET E JASHTME**
- Nevoja të mëtejshme për të adresuar rreziqet ndaj **STABILITETIT FINANCIAR**
- **MJEDISE BIZNESI** të vështira dhe jo-transparente me sektorë informale të konsiderueshëm që shtrembërojnë konkurrencën dhe - për disa - sektorë të mëdhenj publikë që i zënë vendin zhvillimit të sektorit privat
- Liberalizimi i plotë i **TREGJEVE TË ENERGISË DHE TRANSPORTIT**
- **KONSOLIDIMI I TOKËS BUJQËSORE** me të drejta të qarta pronësie dhe mbështetje qeveritare të bazuar në produktiviteti
- **CILËSIA E ULËT E SISTEMEVE TË ARSIMIT** në të gjitha nivelet, mospërputhja mes aftësive dhe nevojave të tregut të punës dhe normat e ulëta të regjistrimit në arsimin parashkollor
- **NIVELE TË ULËTA TË PJESËMARRJES NË TREGUN E PUNËS**, sidomos të grave, papunësia e lartë, veçanërisht për të rinjtë dhe puna joformale
- Mungesa e koordinimit mes **AKTIVIZIMIT TË PUNËSIMIT DHE ASISTENCËS SOCIALE**, kombinuar me sisteme të dobëta të mbrojtjes sociale



SI FUNKSIONON PROCESI?

Komisioni Evropian dhe Banka Qendrore Evropiane përgatishin vlerësimet e tyre për të shtatë programet. Kjo përbën bazën për një dialog shumëpalësh të politikës ekonomike që përfshin vendet e zgjerimit, shtetet anëtare të BE-së, Komisionin dhe Bankën Qendrore Evropiane. Dialogu arrin kulmin në një takim të nivelit të lartë gjatë të cilit pjesëmarrësit miratojnë konkluzione të përbashkëta që përfshijnë udhëzime të politikave për vendin specifik që reflektojnë nevojat më të ngutshme për reforma ekonomike.



GJETJET KRYESORE TË VLERËSIMEVE TË KOMISIONIT PËR PROGRAMET E REFORMAVE EKONOMIKE 2018-2020

Partnerët e zgjerimit po përjetojnë rritje të vazhdueshme ekonomike dhe bëjnë përpjekje për të siguruar stabilitet makroekonomik dhe fiskal në dritën e dobësive aktuale. Politikat e shëndosha duhet të ruhen dhe të forcohen dhe reformat të përshpejtohen. Kjo do të reduktojë riskun ende të vazhdueshëm makroekonomik, do të zhbllokojë burimet për zhvillim të qëndrueshëm afatgjatë dhe do të përshpejtojë konvergjencën me BE-në.



NORMAT E RRITJES EKONOMIKE

Në vitin 2016



Burimi: Macrobond, Eurostat

Lexoni më shumë mbi raportet e vlerësimit:

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/policy-highlights/economic-governance_en